



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**  
**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**  
**Nr. 47, datë 07.11.2017**

**PËR**  
**MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS**  
**KANALIZIME TIRANË SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a si më poshtë :

**a. Tarifë volumetrike për shërbimet:**

<b>Kategoria e klientëve</b>	<b>Furnizim me ujë</b>	<b>Largimi i ujërave të ndotura</b>
Klientë familjar	65 lekë/m <sup>3</sup>	11 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë publik	140 lekë/m <sup>3</sup>	30 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë privat	155 lekë/m <sup>3</sup>	35 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë të veçantë (Prodhim pije alkolike, freskuese, pishina)	170 lekë/m <sup>3</sup>	40 lekë/m <sup>3</sup>
Furra buke	95 lekë/m <sup>3</sup>	13 lekë/m <sup>3</sup>
Shitje uji me shumicë	12 lekë/m <sup>3</sup>	-
HEC Lanabregas	5 lekë/m <sup>3</sup>	-

## b. Tarifë fikse

Klientë familjar	200 lekë/muaj/klient
Klientë publik	200 lekë/muaj/klient
Klientë privat	200 lekë/muaj/klient
Klientë të veçantë (Prodhim pije alkolike, freskuese, pishina)	200 lekë/muaj/klient
Furra buke	200 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018, 2019 dhe në fund të vitit të 5-të ( 2022 ) janë sipas planit të biznesit si më poshtë:

<b>Treguesit e Performancës</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Pritshmëria Viti 2022</b>
Uji Pa të Ardhura (humbjet)	65 %	60 %	40 %
Niveli i matjes	77 %	78 %	97 %
Kohëzgjatja e furnizimit			24 orë/ditë
Efiçenca e stafit			2.45 punonjës/000/lidhje
Mbulimi me ujë	90 %	93.5 %	95.3 %
Mbulimi me kanalizime	78.7 %	80.1 %	83.5 %
Norma e arkëtimit	90 %	91 %	92 %
Cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standarteve	sipas standarteve	sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a do të jetë 0.6 % e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 22.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha UK Tiranë” shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.01.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**

**Ndriçim SHANI**